

I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar zonja dhe zotërinj Deputetë,

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Ju ka paraqitur raportin vjetor për vitin 2018, sipas kërkesave dhe strukturës të manualit të Kuvendit, manual i cili në gjykimin tim ka përmirësuar ndjeshëm cilësinë e raportimit.

Raporti pasqyron veprimtarinë e Autoritetit, zhvillimet kryesore përgjatë vitit, si dhe sfidat e problematikat me të cilat jemi përballur.

Aktiviteti i AMF është mbështetur në tre shtylla kryesore:

1. Në zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ;
2. Në objektivat e përcaktuara në strategjinë 5 vjeçare të AMF; si dhe
3. Në rekomandimet e dhëna nga Kuvendi i Shqipërisë në Rezolutën “Për Vlerësimin e Veprimtarisë së AMF-së për vitin 2017”

Strategjia 2018 – 2022

Në funksion edhe të përmbushjes së objektivave të përcaktuara në strategjinë 5-vjeçare (*janar 2018–dhjetor 2022*) përcaktuam prioritetet kryesore për vitin 2018 të fokusuar te:

- Mbrojtja e konsumatorit dhe investitorit si dhe edukimi financiar i publikut;
- Përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të mbikëqyrjes edhe nëpërmjet rritjes së kapaciteteve profesionale;

- Zhvillimi i tregjeve financiare dhe rritjes së gamës së produkteve në funksion edhe të rritjes së ekonomisë së vendit;
- Forcimi i rolit mbikëqyrës për të patur tregje të shëndetshme dhe moskërcënimin nga rreziqet sistemike;
- Inovacionet teknologjike dhe rritja e transparencës;
- Hartimi dhe miratimi e një kuadri ligjor e rregullativ të harmonizuar me direktivat e Bashkimit Evropian; si dhe
- Forcimi i bashkëpunimit me institucionet brenda dhe jashtë vendit.

AMF në fillim të vitit hartoi një plan të detajuar veprimi në funksion të prioriteteve dhe u angazhua maksimalisht për zbatimin e tij përgjatë gjithë vitit.

Mbrojtja e konsumatorit dhe investitorit

Gjatë vitit 2018 fokusi kryesor në aktivitetin e Autoritetit ka qenë mbrojtja e konsumatorëve në tregun e sigurimeve dhe investitorëve në tregun e kapitaleve. Përgjatë vitit 2018 jo vetëm trajtuam në mënyrë të shpejtë, profesionale dhe efikase ankesat e qytetarëve ndaj subjekteve nën mbikëqyrje, por dhe Drejtoria e Mbrojtjes Konsumatore rriti ndjeshëm inspektimet dhe rolin e saj monitorues.

Në shërbim të transparencës dhe krijimit të lehtësive për qytetarin u krijua platforma e raportimit të ankesave *online* për tregjet nën mbikëqyrje, ku cilido mund të depozitojë një ankesë *online* dhe të ndjekë në kohë reale fazat e shqyrtimit të saj, si edhe përgjigjen përkatëse.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar fushatave për rritjen e edukimit financiar të publikut në zbatim të Strategjisë “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje” që filloi më tetor të vitit 2017. Ndër aktivitetet më të rëndësishme do të përmendja organizimin e Konferencës së parë Kombëtare “Edukimi Financiar” në maj të vitit të kaluar në bashkëpunim me universitetet, ndërsa këto ditë zhvilluam konferencën e dytë.

Gjatë vitit ne zhvilluam leksione të hapura në universitete, të cilat janë finalizuar edhe me nënshkrimin e 7 marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitetet si dhe rritëm prezencën në media dhe në rrjetet sociale.

Ne kemi bashkëpunuar dhe koordinuar me subjektet nën mbikëqyrje dhe universitetet për kryerjen e praktikave mësimore të 300 studentëve për vitin 2019, ku aktualisht deri tani janë rreth 130 studentë që i kanë kryer praktikat mësimore.

Forcimi i rolit mbikëqyrës

Një nga prioritetet është dhe forcimi i rolit mbikëqyrës të Autoritetit ku jemi përqendruar:

Në shëndetin financiar të tregjeve dhe subjekteve nën mbikëqyrje;

Në rritjen e cilësisë së shërbimit, në rritjen e performancës dhe në përmirësimin e qeverisjes korporative të tyre; si dhe

Në marrjen e masave administrative e korigjuese dhe rritjen e kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit.

Gjatë vitit 2018 në forcimin e rolit mbikëqyrës kanë dhënë ndikim:

- Përmirësimi cilësor i analizave financiare (inspektimet *off-site*);
- Rritja e cilësisë dhe inspektimeve në vend (inspektimet *on-site*); si dhe
- Miratimi i rregulloreve të reja dhe përmirësimi i atyre ekzistuese.

Viti 2018 shënon përmbylljen e ciklit të parë të plotë të inspektimeve sipas metodologjisë me fokus rrezikun në të gjithë tregun e sigurimeve dhe tashmë Autoriteti ka profilin e rrezikut të çdo shoqërie.

Vazhdimi i forcimit të rolit mbikëqyrës dhe përmirësimi i kuadrit ligjor e rregullativ këtë vit do të sjellë një standard të ri **në mbikëqyrje, në funksionimin e tregjeve si dhe në shëndetin financiar e performancën e shoqërive nën mbikëqyrje.**

Transparenca e institucionit dhe tregjeve

Në kuadër të transparencës, AMF ka zhvilluar e përmirësuar faqen zyrtare, buletini statistikor është pasuruar me tregues të rinj dhe të dhëna për publikun dhe profesionistët, si dhe janë monitoruar shoqëritë për transparencën ndaj publikut.

Për herë të parë në faqen zyrtare të Autoritetit, në muajin shtator 2018, u publikuan të dhënat e certifikuara dhe të thjeshtuara për të gjitha shoqëritë e sigurimit.

Në funksion të mbrojtjes së investitorit, AMF publikoi gjatë vitit 2018 edhe një sërë paralajmërimesh lidhur me rrezikun e disa produkteve financiare.

Ecuria e tregjeve financiare

Të nderuar deputetë!

Tregu i sigurimeve gjatë vitit 2018, ka vijuar prirjen e tij për zgjerim. Primet e shkruara bruto arritën në rreth 16.93 miliardë lekë, ose 5% më shumë se në vitin 2017. Totali i dëmeve të paguara bruto, në vitin 2018, arriti në 6.98 miliardë lekë, 26% më shumë se në vitin 2017 dhe 47% më shumë se viti 2016.

Raporti dëme/prime arriti shifrën 42%, tashmë po bëhet i krahasueshëm me vendet e rajonit.

Gjatë vitit 2018 janë paguar 1.44 miliard lekë dëme më shumë se viti 2017 kur primet për këtë periudhë janë rritur me 0.8 miliardë, pra rritja në vlerë absolute e pagesës së dëmeve është më e madhe se ajo e rritjes së primeve, tregues që shoqëritë po rrisin performancën dhe cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve.

Procedura e trajtimit të dëmit dhe cilësia e shërbimit është sfida e këtij viti për këtë treg, ku për këtë jemi në fazën përfundimtare të implementimit të regjistrit *online* të dëmeve, financiar nga shoqëritë e sigurimit, ku Autoriteti do të monitorojë *online* procesin e trajtimit dhe pagesës së dëmit dhe çdo konsumator përfitues do të ketë mundësi të ndjekë në kohë reale çdo hap të trajtimit të dëmit.

Një nga zhvillimet kryesore në tregun e sigurimeve përgjatë vitit 2018 ishte **zgjdhja e problematikës së Fondit të Kompensimit mbartur nga viti 2002**

dhe akumuluar vit pas viti, ku një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe Komisioni i Ekonomisë dhe Financave.

Pagesat për Fondin e Kompensimit vetëm për vitin 2018 janë në vlerën mbi 1 miliardë lekë, si dhe u skeduluan për pagesë me këste rreth 204 milion lekë, vlerë e cila është pothuajse sa për 3 vite të marra së bashku 2014-2016. Vetëm pagesat për vitin 2018 kanë qenë 39% më shumë se viti 2017 dhe pothuajse dy herë më shumë se viti 2016.

Bordi i Autoritetit miratoi dy shtesa të Fondit të Kompensimit për vitin 2018 si dhe mori masa ndaj shoqërive për rastet e moszbatimit të vendimeve të AMF-së.

Tregu i **fondeve të investimeve** pësoi një tkurrje prej 6.6% krahasuar me një vit më parë. Arsytet e tkurrjes kanë ardhur si rezultat i kthimeve të ulëta nga investimi, për shkak të normës bazë shumë të ulët të lekut dhe valutave, si edhe nga efekti i kursit të këmbimit. Totali i aktiveve neto nën administrim të fondeve të investimit në fund të vitit 2018 ishte 66 miliardë lekë, duke zënë një peshë prej rreth 4% ndaj PBB. Vlen të theksohet se tregu i fondeve të investimeve u zgjerua me dy fonde të reja investimi si dhe me një shoqëri të re administruese.

Risia **në tregun e kapitaleve** për vitin 2018 ishte fillimi zyrtarisht i veprimtarisë së Bursës Shqiptare të Titujve, ALSE. Sistemi i tregtimit të Bursës monitorohet nga Autoriteti në kohë reale, në funksion të mbrojtjes së interesave të investitorëve dhe sigurimit të një tregu të drejtë dhe transparent. Gjatë vitit të parë të aktivitetit të saj vlera totale e tregtimit në Bursë arriti në nivelin rreth 1.4 miliardë lekë, ku kanë dominuar transaksionet me bono thesari të kryera midis bankave.

Tregu i **fondeve të pensionit vullnetar**, megjithëse modest, ka vijuar prirjen për zgjerim. Totali i asetëve neto të këtij tregu për vitin 2018 ishte 2.3 miliardë lekë me një rritje me 33% krahasuar me vitin 2017, ndërsa numri i anëtarëve u rrit me 21% duke shkuar në 25,300 anëtarë.

Kuadri Rregullator

Përsa i përket **kuadrit ligjor dhe rregullator** të tregjeve nën mbikëqyrje, në vitin 2018, Autoriteti finalizoi hartimin e projektligjit “Për sigurimin e

detyrueshëm në sektorin e transportit”, të cilin e kemi depozituar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Edhe në tregun e kapitalit, Autoriteti në bashkëpunim me konsulentët e projektit të financuar nga Sekretariati Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), me mbështetjen e Bankës Botërore, përfundoi projektligjet “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe “Për Tregjet e Kapitalit”. Këto projektligje janë hartuar në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian dhe synojnë krijimin e një tregu transparent dhe të mirëregulluar të kapitaleve, si edhe nxisin zhvillimin e tij. Aktualisht janë në fazën e konsultimit publik dhe marrjen e opinioneve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Dua të theksoj se Autoriteti e vlerëson me shumë rëndësi miratimin e këtyre projektligjeve, si edhe ndryshimet e propozuara në Ligjin “Për Fondet e Pensionit Vullnetar”, jo vetëm për rëndësinë që ato kanë në zhvillimin dhe rregullimin e mëtejshëm të tregjeve nën mbikëqyrje, për ndikimin direkt në rritjen ekonomike të vendit, por edhe plotësojnë rekomandimet e progres-raportit të Komisionit Evropian, të publikuar ditën e djeshme, për sektorin financiar jobankar.

Gjatë vitit 2018 janë hartuar 11 rregullore dhe udhëzime të reja, si edhe janë ndërmarrë ndryshimet e nevojshme në 19 rregullore, ku fokusi ka qenë mbrojtja e konsumatorit në tregun e sigurimeve dhe investitorit në tregun e kapitaleve.

Do të veçoja ndryshimin e Rregullores “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, e cila ka të bëjë me llogaritjen e vlerës së dëmshpërblimit për dëme shëndetësore. Koeficientët e përdorur deri përpara ndryshimit i referoheshin të dhënave mbi studimet e popullsisë të Italisë në vitin 1922, para një shekulli. Pas nënshkrimit të marrëveshjes dhe bashkëpunimin me INSTAT, u përditësuan të dhënat e jetëgjatësisë duke bërë që nga 1 korriku i vitit 2018 palët përfituese të kenë një rritje të konsiderueshme të dëmshpërblimit, mesatarisht me 38%.

Në funksion të një mbikëqyrjeje efektive të grupeve për të administruar më mirë rreziqet që mund të transferohen nga vendet e huaja, ku shoqëritë shqiptare kanë investime, u miratua Udhëzimi Metodologjik “Mbi mbikëqyrjen e grupit të sigurimit”. Nën drejtimin e AMF u krijuan Kolegjet Mbikëqyrëse Rajonale me

pjesëmarrjen e 3 rregullatorëve AMF, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Maqedoninë e Veriut (ISA).

Zhvillimet TI

Në kushtet e globalizimit dhe **inovacionit në sektorin financiar** (FinTech), Autoriteti mbetet i angazhuar për zbatimin e teknologjive të reja në funksion të mbikëqyrjes sa më efektive. Gjatë vitit 2018 ka pasur zhvillime të rëndësishme në infrastrukturën e brendshme të teknologjisë së informacionit si:

- Është përmirësuar “Regjistri Elektronik i Sigurimit të Detyrueshëm Motorik”;
- Është realizuar integrimi për herë të parë me regjistrin e Qendrës Kombëtare të Biznesit për shkëmbimin e të dhënave;
- Është krijuar baza e ruajtjes së të dhënave *backup* pranë AKSHI-t për sistemet që administron Autoriteti.

Në zbatim të rezolutës së Kuvendit, për mundësinë e raportimit *online* të policave të sigurimit të punonjësve në miniera, Autoriteti ka filluar zbatimin e projektit për zhvillimin e këtij sistemi, i cili aktualisht është në fazën e testimit nga tregu dhe do të aplikohet këto muaj. Në këtë projekt është shtuar edhe raportimi *online* i sigurimit të pasagjerëve.

Bashkëpunimi institucional

Autoriteti ka patur angazhime konkrete për të forcuar **bashkëpunimin institucional në nivel vendor dhe ndërkombëtar**. Kështu, Autoriteti ka forcuar bashkëpunimin dhe kryer inspektime të përbashkëta me Bankën e Shqipërisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Policinë e Shtetit si dhe filloi bashkëpunimin me INSTAT, AKSHI-n dhe Qendrën Kombëtare të Biznesit. Autoriteti ka bashkëpunuar, nënshkruar Memorandume Mirëkuptimi dhe zhvilluar takime të vazhdueshme me autoritetet homologe nga Austria, Kosova, Italia, Maqedonia e Veriut, Kroacia, etj.

AMF ka kërkuar bashkëpunim dhe me institucione të tjera në vend të cilat me detyrimet ligjore, kapacitetet dhe vendimet e tyre ndikojnë në tregjet që

mbikëqyrim. Për rastet e konstatuara nga ana jonë për problematikat e funksionimit të tregjeve i kemi parashtruar pranë Autoritetit të Konkurrencës, i cili pas referencës nga ana jonë ka hapur hetimet dhe ka marrë vendimet përkatëse. AMF në të gjitha rastet ka adresuar rekomandimet e lëna nga ky institucion.

Përsa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar, Shqipëria po bëhet gjithnjë e më shumë vendtakim i rregullatorëve dhe aktorëve të rëndësishëm të tregjeve nën mbikëqyrje. Vitin e kaluar zhvilluam në Tiranë dy konferenca ndërkombëtare në bashkëpunim edhe me Autoritetin Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) dhe Bankën Botërore.

Falë bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe marrëdhënies profesionale të AMF-së me organizatat në të cilat aderon, Shqipëria u votua nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS), si vendi organizator i konferencës më të madhe vjetore në nivel botëror për autoritetet mbikëqyrëse të tregut të pensioneve, e cila do të zhvillohet në Tiranë në nëntor të këtij viti.

Autoriteti gjatë viteve të fundit zbatoi projektin e asistencës teknike “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregjeve të kapitalit”. Projekti u mbështet nga Banka Botërore dhe u financua nga Sekretariati Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO). Përmbyllja me sukses e këtij projekti në mars 2019 dhe vlerësimet shumë pozitive për realizimin e projektit nga Banka Botërore dhe SECO, hapi rrugën që SECO të aprovojë një grant tjetër për përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës ligjore dhe rregullative, i cili është në proces vlerësimi nga qeveria.

Raportet dhe misionet e institucioneve ndërkombëtare

Gjatë vitit kemi zhvilluar takime me përfaqësues të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, të Komitetit të Ekspertëve MONEYVAL, si dhe kemi qenë pjesë e raporteve të tyre për vlerësimin e aktivitetit të Autoritetit.

Fondi Monetar Ndërkombëtar ka vlerësuar punën e kryer nga Autoriteti duke u shprehur në raportin e vitit të kaluar për “*vital progress*” me adoptimin rregulloreve përkatëse që lidhen me tregun e kapitaleve dhe fondeve. Ky konkluzion është përforcuar në raportin e fundit, ku është shprehur se “Rregullatori i institucioneve financiare jobanka ka zgjeruar kuadrin rregullator në lidhje me tregjet e kapitalit”.

Në raportet zyrtare të **Bankës Botërore** përmenden ndryshimet pozitive që kanë ndodhur në funksionimin e institucionit, rritjen e kapaciteteve të mbikëqyrjes, si dhe zgjidhjen e problemeve të akumuluar nga vitet e mëparshme. Raporti i fundit i Bankës Botërore i datës 14 Maj 2019 citonte se “Autoriteti ka patur përkushtim të lartë dhe ecuri të kënaqshme në zbatimin dhe produktet e projektit”.

Progres-raporti i publikuar dje vlerëson punën e Autoritetit në kapitullin IX “Për shërbimet financiare” duke përmendur vazhdimin e zbatimit të strategjisë për rritjen e besimit të konsumatorëve dhe të investitorëve, përmirësimin e rregulloreve në tregun e sigurimeve për t’u përqasur me direktivat, zhvillimet në tregjet e kapitaleve dhe ku janë forcuar kërkesat për likuiditet. Progres-raporti vlerëson strategjinë 5 vjeçare të Autoritetit dhe rekomandon disa ndryshime ligjore të cilat janë depozituar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Autoriteti ka zbatuar të gjitha rekomandimet e raportit të **Komitetit të Ekspertëve MONEYVAL** dhe zbatuar planin e veprimit miratuar nga Këshilli i Ministrave. Masat e marra u shoqëruan me ndryshime në aktet rregullatore, me inspektime pothuajse në të gjitha subjektet që mbikëqyrin si dhe me trajnimin e stafit për këtë fushë. Njëkohësisht është forcuar bashkëpunimi me DPPPP duke ushtruar inspektime të përbashkëta. Kategorizimi i rrezikut për subjektet nën mbikëqyrje nga Autoriteti është i ulët.

Objektivat dhe sfidat për vitin 2019

Të nderuar deputetë,

Dinamika e tregjeve financiare, zhvillimet e teknologjisë së informacionit, proceset integruese për në BE ku Autoriteti është drejtues i kapitullit IX, roli që duhet të ketë në ekonominë e një vendi, objektivat që ka vetë Autoriteti na vendosin përpara sfidave të reja.

Përtej gjithë punës së bërë, ne jemi të vetëdijshëm se tregjet financiare për natyrën specifike, ndryshe nga çdo treg tjetër, duan kohën e tyre të krijojnë besim, zhvillimi duhet të jetë i kujdesshëm dhe kërkojnë një mbikëqyrje efektive.

Për tregje të besueshme dhe të orientuar nga zhvillimi është e domosdoshme që të vazhdojmë të rrisim kapacitetet mbikëqyrëse si dhe të përmirësohet ndjeshëm qeverisja korporative e shoqërive nën mbikëqyrje.

Për vitin 2019 ne kemi miratuar planin e veprimit mbështetur te objektivat kryesorë dhe i fokusuar te:

Mbikëqyrja, monitorimi dhe zhvillimi i tregjeve;

Mbrojtja e konsumatorit dhe investitorit;

Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse;

Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullativ;

Modernizimi i infrastrukturës së teknologjisë të informacionit dhe kapaciteteve të Qendrës së Informacionit;

Inovacionet e teknologjisë së informacionit për të qenë ndër vendet e para për të zhvilluar dhe përfituar nga teknologjitë e reja në fushën financiare.

Objektivat dhe plani i veprimit janë në funksion të synimit të AMF-së, të shpallur në “Strategjinë për zhvillimin e tregjeve nën mbikëqyrje 2018-2022” që **tregu financiar jobankar në Shqipëri nga më i brishti në Ballkanin Perëndimor, në fund të vitit 2022 të shndërrohet në tregun më të konsoliduar, lider i Ballkanit Perëndimor.**

Ju Faleminderit!